

STATUSI

18.09.2023

!

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

“D+PLUS ” SHPK

HYRJE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar ““ D+PLUS ”” Sh.P.K eshte themeluar nga 1 Ortake z. **Taulant Manaj** .

Themeluesi ne perputhje me ligjin hartojne edhe statusin e shoqerise si me poshte:

NENI 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Emertimi i shoqerise eshte “ D+PLUS ”

NENI 2

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptare ne fuqi dhe vecanerisht ne baze te Ligjit 9901 dt. 14.04.2008 “Per shoqerite Tregetare” si dhe Ligjit 9723 dt 03.05.2007 “Per QKR e formalitetet qe duhen respektuar per shoqerite tregetare, aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise si dhe me dispozitat e Statusit te shoqerise.

NENI 3

FORMA

Shoqeria D+PLUS ” eshte Shoqeri me Pergjeghesi te Kufizuar (Sh.P.K.)



NENI 4

SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuara "**D+PLUS**" shpk eshte ne Lushnje, Saver Lagje Saver, rruga Fier-Lushnje ne km 23, godine 1 kateshe me nr - 82.

Kjo shoqeri ,gezon te drejten e hapjes e bashkepunimit me filjalet si brenda ashtu dhe jashte vendit.

NENI 5

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuara "**D+PLUS**" Sh.p.k eshte mbi dhjete vjete. Shoqeria mund te pushoje veprimtarine e saj, me vendim te Asamblerse se ortakeve kur ai verifikon rethana te tilla kur shperndarja urdherohet ne menyre te shprehur ne ligj.

NENI 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise "**D+PLUS**" Sh.p.k eshte:

Import-Export i fruta perimeve.

Per kryerjen e aktiviteteve te mesiperme te shoqerise ,per te cilat do te nevojitet leje perkatese ,shoqeria eshte e detyryar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organet kopetente.

NENI 7

Shoqeria, mund te ndryshoj emertimin, selin, objektin e veprimtarise se saj me vendim te Asamblese se ortakeve.

NENI 8

KAPITALI I SHOQERISE.

Kapitali themelor i shoqerise "**D+PLUS**" Sh.p.k ka vleren 100.000(dhjetemije) lekei cili ndahet ne 1 kuote, nga 1 Ortake z. **Taulant Manaj 100%**,kjo vlere do te ngurtesohet ne banke mbasi shoqeria te rregjistrohet ne Q.K.B .

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet, me vendim te mare nga Asambleja e ortakeve.



NENI 9

TRASFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

Pjeset e kapitalit jane lirisht te trasferueshme me vendim te asamblese se ortakeve.

NENI 10

Ortaket perballen me humbjen deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

NENI 11

ORGANET E SHOQERISE, ADMINISTRIMI

Organi kryesore i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve.

Vedimet e asamblese se ortakeve meren me 51 perqind te votive dhe ne perputhje me ligjin. regjistrohen ne librin e shoqerise.

Asambleja e ortakeve vendos emerimin apo shkarkimin e Administratorit, Audituesin Ligjore, dhe likuduesve, miratimin e llogarive vjetore, ndarjen e fitimit etj.

Gjithashtu Asambleja e ortakeve vendos per ndryshimin Statutit, zvogelim ose zmadhim te kapitalit themeltar, por jo me pak se 10.000 leke, si dhe likuidimin e saj.

Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te Ligjeve, statutit apo faje te kryera gjate adminsitrimite te shoqerise.

NENI 12

Administrator i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuara “ **D+PLUS** ” eshte **Z Taulant Manaj** i cili zgjidhet per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje

NENI 13


Administratori kryen cdo veprimtari ne interes te shoqerise brenda objektit te veprimtarise se saj.

NENI 14

Cdo i interesuar mund te kerkoj ne Gjykate anullimin e vendimit te Asmblese se ortakeve te marre ne kundertshtim me ligjin apo normat e ketij statute.

NENI 15

Shoqeria merre persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit dhe kur keto nuk perfshihen ne objektin e veprimtarise se saj, me perjashim te rasteve kur ajo provon se te tretet e dinin se akti i administratorit tejkalon objektivin e shoqerise apo rrethanat nuk mund te injoronin kete fakt.



NENI 16

Administratorit të shoqërisë i takon firma e shoqërisë dhe përfaqësimi i saj ndaj të tjerëve.

NENI 17

BILANCI DHE FITIMET.

Viti financiar i shoqërisë është periudha nga 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor. Administratori harton inventarin dhe llogaritë vjetore sipas dispozitave të kontabilitetit dhe harton një raport me shkrim për administrimin dhe e paraqet në asamblenë e përgjithshme për miratim.

Miratimi i raporteve financiare mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej gjashtë muajesh nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 18

Perderisa "rezerva e ligjore" të arrijë 1/20 pjesë të kapitalit themeltar shoqëria është e detyruar të depozitojë 1/20 e fitimit të realizuar.

NENI 19

Fitimet, pasi të jenë depozituar shumat e urdheruar për rezerven e të tjera, i takojnë ortakëve të shoqërisë.

NENI 20

Bilanci vjetor duhet të paraqitet në organet tatimore, pasi miratohet nga Asambleja, brenda datës 31. Mars të vitit pasardhës.

NENI 21

MBARIMI I SHOQËRISË

Veprimtaria e shoqërisë mbaron me vendim të arsyetuar të Asamblese, në rastet e parashikuara në ligj.

NENI 22

LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Shpërndarja e shoqërisë, për çdo lloj arsye përveç falimentimit, bëhet nëpërmjet likuidimit, përderisa të kryehet ky veprim quhet se shoqëria funksionon. Shoqëria mban emerin e vet në të cilën shtohet në likuidim e sipër duke bërë veprimet e duhura në regjistrin tregëtar.



NENI 23

Likuidimi i shoqërsisë vendoset me vendim të arsyetuar të Asamblesë së cila për të kryer veprimet që kërkojnë, emëron një likuidator me tagrat e përcaktuara në ligjin 9901 dt. 14.04.2008. "Për Tregëtarët dhe shoqëritë Tregëtare". Likuidatori është përgjegjës si ndaj shoqërisë ashtu dhe ndaj të tjerëve. Ai shpërbehet në bazë të vendimit të Asamblesë

NENE 24

Likuidatori i emëruar përfaqëson shoqërinë dhe nënshkruar duke vënë firmën nën vulën e shoqërisë. Ai duhet të perfundojë shitjet që janë të disponueshme për llogaritë të shoqërisë, të marrë nga çdo detyrues llogaritë të sakta në monedhë dhe të kthejë pasurinë e shoqërisë në para. Për çështjet e mbetura pezull vendos Asambleja e shoqërisë për zgjidhjen e tyre. Në përfundim të likuidimit të shoqërisë likuidatori përpilon bilancin përfundimtar dhe të nxjerrë buletinin përkatës.

NENI 25

Në rast të likuidimit të shoqërisë, caktohet likuidatori, i cili merr të gjitha atributet e administratorit, duke qenë i detyruar të njoftojë për punët e shoqërisë.

NENI 26


MARRREDHENIET E PUNES.

Marredheniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet dispozitave të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Të gjithë personat e punësuar në shoqërinë "**D+PLUS**" shpik kanë të drejtë të përcaktojnë marredheniet e punës nëpërmjet Kontrates së Punës dhe Kontrates Kolektive të Punës.

NENI 27

Mosmarreveshjen e punës zgjidhen nga Gjykata e Rrethit, kur mjete të tjera nuk japin rezultat. Shoqëria respekton rregullat e punësimit dhe të sigurimeve Shoqërore, ndërsa të punësuarit janë të detyruar që të pranojnë e zbatojnë ato. Të gjithë të punësuarit janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës.



NENI 28

PERFAQESIMI

Perfaqesimi i shoqerise, i cili ka te drejte te perfaqesoje shoqerine te te tretet, organet gjyqesore, te caktojne avokat si dhe ne marredheniet me sistemin fiskal e organet e tjera shteterore, percaktohet nga Administratori

NENI 29

Gjithe veprimtaria e shoqerise ne aspektin ekonomik drejtohet nga Administratori. Pjesamarrja me shoqeri te tjera, ndryshimi statute, kapitali themeltar, miratimi bilancit, pranimi i ortakve te rinj percaktohet nga Asambleja e ortakeve.

NENI 30

DISPOZITAT TE PERGJITHSHME

Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut, do te zbatohen dispozitat e Ligjit 9901dt. 14.04.2008 "Per shoqerit tregeteare. Ligji 9723 dt 03.05.2007 "Per QKB. si dhe cdo dispozite e Legjislacionit Shqiptre qe gjen vend ne keto marredhenie juridike e tregetare

NENI 31

Shoqeria fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregetar pran QKB

Ky status nenshkruset nga themeluesi

ORTAKU I VETEM

TAULANT MANAJ

